Kronikë

EMRI/ Vritet 38-vjeçari në Sukth, qëllohet me automatik brenda makinës! Ishte me një shok në mjet! 10 persona merren në pyetje

Një 38 vjeçar është vrarë nga persona ende të paidentifikuar në Katund Sukth tek shinat e trenit në Durrës. Viktima është zënë në pritë tek shinat e trenit në Sukth dhe është qëlluar me breshëri plumbash me automatik. 2 plumba e kanë përshkuar në trup duke i dëmtuar organet vitale, por pritet ekspertiza

- I vëllai i viktimës plagosi rreth 2 vite më parë me pistoletë të dashurën e tij në një hotel në Durrës
- Fatjon Dervishi ishte me një shok në makinë kur u qëllua! Ja çfarë tha në polici

Redaksia
27 Shtator, 00:38 | **Përditesimi: 27 Shtator, 10:12**

DURRES - Një 38 vjeçar është vrarë me armë zjarri nga persona ende të paidentifikuar në Katund Sukth tek shinat e trenit në Durrës. Ngjarja u shënua pak pas mesnatës (27 shtator). Shqiptarja.com mëson se Fatjon Dervishi ndërroi jetë në spital.

> *'Në Katund, Sukth, tek shinat e trenit, nga persona ende të paidentifikuar është qëlluar me armë zjarri shtetasi Fatjon Dervishi, 38 vjeç, i cili u transportua menjëherë në spital për ndihmë mjeksore, por si pasojë e plagëve të marra ka ndërruar jetë në spital" informoi policia e Durrësit pas mesnate (ora 00:30), 27 shtator 2023.*

LEXO EDHE:
Tentoi të vidhte një automjet në Durrës, kapet në flagrancë autori

Gazetari i Report Tv Artur Korriku raporton se viktima është zënë në pritë tek shinat e trenit në Sukth dhe është qëlluar me breshëri plumbash me automatik. 2 plumba e kanë përshkuar në trup duke i dëmtuar organet vitale, por pritet ekspertiza.

Në momentin kur e kanë qëlluar ka qenë në automjet së bashku me një shokun e tij dhe ishte duke drejtuar makinën. Personi tjetër nuk është prekur nga plumbat. Sipas dëshmisë së këtij të fundit rezulton se ata kishin qenë në një lokal dhe po ktheheshin për në shtëpi kur janë goditur. Janë pyetur 10 persona deri tani për të mundësuar zbardhjen e ngjarjes.

Viktima është banor i zonës Katund Sukth dhe nuk është person me precedent të mëparshëm penal, ndërsa mësohet se ka jetuar edhe jashtë vendit. Megjithatë familjarë të tij janë emra të njohur nga policia. Vëllai i Fatjon Dervishit, Fatbardh Dervishi, në janar të vitit 2022 ka plagosur me ***pistoletë të dashurën*** në një hotel në Durrës.

Ndaj ***Fatbardh Dervishit*** është caktuar masa e sigurisë "Arrest në burg", në mungesë, për plagosje të rendë me dashje dhe armëmbajtje pa leje. Ndërsa babai i tyre është prangosur Ramazan Dervishi është prangosur për armëmbajtje pa leje.

Grupi hetimor ka shkuar në vendngjarje dhe në bashkëpunim me Prokurorin vijon veprimet për zbardhjen dhe dokumentimin e rrethanave të ngjarjes, me qëllim identifikimin dhe kapjen e autorit/ve.

Kjo është vrasja e dytë e shënuar në vend pa kaluar 24 orë. 59 vjeçari **Martin (Marku) Bardhi u ekzekutua** paraditen e 26 shtatorit, në një atentat të mirëorganizuar në hyrje të qytetit të Rrëshenit, ndërsa tre persona të tjerë të cilët kanë qenë në tavolinë u plagosën. Vrasja u shënua përballë komisariatit të Rrëshenit në bar picerinë e viktimës.

Lajm në përditësim...

1 / 4



Foto nga vendi ku u vra Fatjon Dervishi në Katund Sukth të Durrësit, 27 shtator 2023

Rendit zhvillimet sipas orarit: Të Fundit

Ora 09:54

Vrasja e Fatjon Dervishit, vëllai i viktimës plagosi kohë më parë me pistoletë të dashurën në një hotel në Durrës

Ende nuk ka asnjë autor të dyshuar për vrasjen e Fatjon Dervishit pak pas mesnate në Katund Sukth në Durrës pak pas mesnate.

Burime për Report Tv bëjnë me policia po heton edhe në pistën e hakmarrjes pasi vëllai i Dervishit, Fatbardh Dervishi në janar të vitit 2022 ka plagosur me ***pistoletë të dashurën*** në një hotel në Durrës.

Asokohe Fatbardh Dervishi u shpall në kërkim, por nuk është arrestuar nga policia.

Ndaj ***Fatbardh Dervishit*** është caktuar masa e sigurisë "Arrest në burg", në mungesë, për plagosje të rendë me dashje dhe armëmbajtje pa leje.

Materialet i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, për veprën penale "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyese dhe i municionit".

M.Q./Shqiptarja.com

Ora 07:31

Vrasja e Fatjon Dervishit në Durrës, ishte me një shok në makinë kur u qëllua! Ja çfarë tha në polici miku i tij

Report TV mëson të tjera detaje në lidhje me vrasjen e Fatjon Dervishit pak pas mesnate në Durrës.

Viktima është banor i zonës Katund Sukth dhe nuk është person me precedent të mëparshëm penal.

Në momentin kur e kanë qëlluar Fatjon Dervishi ishte duke drejtuar makinën dhe bashkë me të në mjet ka qenë edhe një shoku i tij.

Mësohet se 38-vjeçari është qëlluar me armë automatike. 2 plumba e kanë përshkuar në trup duke i dëmtuar organet vitale. Ende nuk ka dalë rezultati i ekspertizës.

Personi tjetër nuk është prekur nga plumbat.

Sipas dëshmisë së këtij të fundit rezulton se ata kishin qenë në një lokal dhe po ktheheshin për në shtëpi kur janë goditur.

Policia e Durrësit e përforcuar nga forca policore të ardhur nga Tirana po punon për zbardhjen e ngjarjes Janë pyetur 10 persona deri tani për të mundësuar zbardhjen e ngjarjes.

M.Q./Shqiptarja.com

S.G/KT/Shqiptarja.com

TAG: vrasje | Durres | fatjon dervishi | vritet fatjon dervishi

Komento

Komente

Dauti: 27/09/2023 06:08
Do jete i njejti grup zjarri kane mbaru pune ne mirdite dhe kane ardh der n sukth kada kadale....kush do i gjeje policia jone,qe me i hy nji gisht m bythe s di me e qit ma
Përgjigju

Ate llafshen: 27/09/2023 01:38
Ate llafshen keni per te na ngren sic na i keni ngren deri me sot. Po nuk e dini llafshen ca esht pyetni motrat edhe grat se e din ato edhe ju a shpjegojn
Përgjigju

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
Sulmi në Veri të Kosovës, a rrezikohet një konflikt në rajon?
Po | Jo | Nuk e di

Lajme të tjera

Partizani dhe Kamza në gjysmëfinale të Kupës së Shqipërisë, basketbolli fillon sezonin e ri — 26 Shtator, 14:19
Sekuestrohen 2 bombola me helium në portin e Durrësit, në hetim 47-vjeçari banues në Angli — 26 Shtator, 13:18
Durrës/ Çfarë e shkaktoi zjarrin në fabrikën e bojrave 'Deutsch Color' në autostradë? Dy pistat e hetimit — Artur Korriku — 26 Shtator, 10:02
E fundosur në basenin ujor të Portit të Durrësit, nxirret nga uji anija e peshkimit — 25 Shtator, 14:44
Zjarr në servis, shkrumbohen makinat në Durrës — 25 Shtator, 10:51
Larguan Diego Longon, Teuta rikthen për herë të pestë në stol Edi Martinin — 24 Shtator, 22:02
Zyrtare/ Vetëm katër ndeshje, Diego Longo s'është më trajner i Teutës — 24 Shtator, 16:10
Zjarri në fabrikën 'Deutsch Color', nisin hetimet për shkakun! Roja e sigurisë: Nisi brenda ambienteve! Pronari: Mosrespektimi i kontratave, dëmi më i madh (VIDEO) — Artur Korriku — 24 Shtator, 09:54
EMRAT/ Ndezën zjarr dhe dogjën sipërfaqe të mëdha toke dhe tre godina, arrestohen 2 persona në Durrës — 23 Shtator, 12:50
VIDEO/ Digjet një banesë private mes pallateve në Durrës, zjarri dyshohet të jetë vënë nga disa endacakë — 23 Shtator, 11:01
VIDEO/ Durrës, gjenden 250 mijë euro të fshehura në furgonin e ardhur nga Italia me medikamente! Arrestohet shoferi — 23 Shtator, 10:45
Si u fshehën 522 mijë euro në furgonin e ardhur nga Bari, 6 qese plastmasi plot me blloqe me para ishin fshehur tek impiantit të kondicionerit — 23 Shtator, 10:39

Lajmi i fundit: Fier, 50 vjeçarit i gjejnë në shtëpi 3100 fara kanabisi, kishte mbjellur dhe në oborr — 27 Shtator, 10:22
RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

© 2011 - 2023 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje